



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

FSHMN

Ref. nr.

2385

Prishtinë, Dt.

11.07.2024

RAPORT VLERËSIMI TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMES
MASTER

FAKULTETI	FSHMN
Departamenti/ Programi	Biologji/ Ekologji – Mbrojtje e Mjedisit
Projektpropozimi	Potenciali antimikrobik dhe izolimi i llojeve të baktereve në mostrat e mjaltit të prodhuara në Rrafshin e Dukagjinit dhe Rrafshin e Kosovës
Kandidati	Artiola Zeneli
Mentori	Prof. Dr. Idriz Vehapi
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e Fakultetit	Datë: 26.01.2024 Vendimi nr.: 239

PËRMBLEDHJE E PUNIMIT

Punimi i diplomës master i kandidatës Artiola Zeneli, trajton një çështje me rëndësi të madhe për mjedisin dhe interesin publik. Ky studim hulumton izolimin dhe identifikimi e baktereve që janë të pranishme në mostrat e mjaltit, ekzaminimin e efekteve antibakteriale të mostrave të ndryshme të mjaltit, përcaktimin nëse mjalti i prodhuar nga bletët e dy regjioneve të Kosovës përmban baktere që prodhojnë metabolitë me potencial të frenimit të rritjes kundër patogjenëve të rëndësishëm njerëzor, përcaktimin e origjinës botanike të mjaltës së prodhuar në efektin antimikrobial dhe matjen e sasisë së metaleve prezentë në mostrat e mbledhura nga lokalitetet të ndryshme, në dy regjione të Kosovës.

Kandidatja Artiola Zeneli, fillon punimin e saj duke përshkruar rëndësinë e mjaltës, veçoritë biologjike dhe ushqyese të mjaltit, vetit fizike të mjaltit, përbërja kimike e mjaltit, çlësia e mjaltit, llojet e mjaltit, aktivitetin antibakterial dhe përdorimin e gjerë të mjaltit në mjekësi, përdorimin e bletëve të mjaltit në biomonitorim, ndotjen mikrobiologjike dhe kimike të mjaltit dhe kristalizimi i mjaltës - përdorimin e

mikrovalës.

MATERIALI DHE METODAT

Pjesa e metodologjisë përshkruan hapat e ndjekur për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave. Janë përdorur metoda të ndryshme laboratorike për të analizuar mostrat e mjaltit nga lokalitetet e ndryshme dhe me origjinë të ndryshme bimore. U përdoren metoda të standardizuara për të matur parametrat mikrobiologjikë, efektin antimikrobial dhe përqendrimin e metaleve.

REZULTATET DHE DISKUTIMI

Diskutimi i punimit të diplomës master të kandidatës Artiola Zeneli, është një pjesë thelbësore e këtij studimi, duke ofruar një analizë të thellë të dhënave eksperimentale dhe interpretimin e rezultateve të fituara. Në hulumtimin e kryer në mostrat e mjaltit janë izoluar mikroorganizmat, si: *Aspergillus sp.*, *Bacillus sp.*, *Baellus sp.*, *Pseudomonas sp* dhe *Salmonella sp*, ndërsa *E.coli* nuk është izoluar në asnjërën nga mostrat e mjaltit. Sa i përket potencialit antimikrobik të mjaltës, është kryer për llojet *Aspergillus flavus*, *Candida albanicans*, *E.coli* dhe *Staphylococcus aureus*. Efekt më të fuqishëm antimikrobial shumica e mostrave të mjaltit kanë dhënë për *Candida*, *Staphylococcus* dhe *E.coli*, ndërsa kundër gjinis *Aspergillus* nuk ka dhënë efekt. Ndërsa në aspektin e metaleve janë analizuar metalet e rënda: Cd, Co, Cr, Cu, Fe, Mn, Mo, Ni, Pb dhe Zn. Ku vlen të theksohet se Plumbi në 20 mostra ka rezultuar me sasi nën nivelin e detektimit nga pajisja ICPE-9820, ndërsa në dy lokalitete në Dragash – mjaltë livadhi dhe në Podujevë – mjaltë livadhi dhe bjeshke, ka tregu rezultat pozitiv. Po ashtu Zinku ka rezultuar me një sasi më të madhe në lokalitetin e Dragashit – mjaltë livadhi, Mangani me sasi më të madhe në lokalitetin e Podujevës – mjaltë livadhi dhe bjeshke, Molibdeni në të gjitha lokalitetet ka tregu rezultat pozitiv të prezencës së tij ndërsa në një lokalitet në Podujevë - mjaltë livadhi dhe bjeshke ka tregu rezultat negativ. Metalet alkaline: Na dhe K, metalet alkalino tokësor: Be, Mg dhe Ba, elementet e grupit 13, 15 dhe 16 të sistemit periodik të elementeve kimike: Al, As dhe Se, të rezultuara me përqendrim të ndryshëm për lokalitete të caktuara. Ndotja e mjaltës me metale vije si rezultat i: ndotjes industriale, përdorimi i pesticideve të shumta në bujqësi, ndotësit nga ajrit etj.

REKOMANDIMET

Bazuar në rezultatet e fituara janë propozuar disa rekomandime:

- Instalimi i koshereve të bletëve të jetë në distancat sa më të largëta nga një mjedis industrial i

ndotur me metale të rënda;

- Mos përdorimi i pesticideve në afërsi të koshereve të bletëve ose vendosja e tyre larg tokave bujqësore;
- Rritja e ndërgjegjësimit të popullatës mbi rëndësinë e bletës në planet dhe ndikimet e ndotjes në produktet e sajë;
- Forcimi i rregulloreve dhe politikave mjedisore për të kontrolluar dhe reduktuar ndotjen nga burimet industriale dhe bujqësore;
- Pastroni dhe dezinfektoni rregullisht pajisjet dhe veglat e përdorura në punën me kosheret e bletëve.
- Përdorni materialet e duhura për ndërtimin e kosheres, si druri i papërpunuar dhe jo i trajtuar me kimikate.
- Siguroni që bletët të kenë qasje në ujë të pastër dhe në lule natyrale që nuk janë të spërkatura me pesticide.
- Monitoroni dhe trajtoni problemet shëndetësore të bletëve, si sëmundjet e ndryshme që mund të ndikojnë në cilësinë e mjaltit.

VLERËSIMI I KOMISIONIT

Bazuar në analizën e dorëshkrimit të punimit të diplomës master të kandidatës Artiola Zeneli, komisioni profesional sjell këto vlerësime:

Kandidatja ka dorëzuar punimin e saj në formë të plotë dhe sipas kërkesave të Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe Rregullores për studime master.

Rezultatet eksperimentale janë trajtuar në mënyrë shkencore dhe me përpikëri, duke përmbushur standarde akademike të kërkuara. Ky aspekt demonstroi aftësinë e kandidatës për të kryer kërkime të mirëfillta shkencore dhe për të interpretuar të dhënat në mënyrë të saktë dhe të kuptueshme.


Kandidatja ka demonstruar një përvojë të shkëlqyeshme në aplikimin e metodave për analizimin e mostrave të mjaltës. Kjo tregon jo vetëm njohuritë teorike, por edhe aftësinë për të zbatuar këto njohuri në


praktikë, duke sjellë zgjidhje konkrete për problemet mjedisore.


Komisioni profesional vlerëson pozitivisht këtë dorëshkrim të punimit të masterit dhe propozon që kandidates Artiola Zeneli, ky punim t'i aprovohet si bazë për arritjen e gradës shkencore Master i Shkencave të Biologjisë.

Prishtinë, 11.07.2024

Komisioni:

1. 
/ Prof. Dr. Kasum Letaj - kryetar/

2. 
/ Prof. Dr. Idriz Vehapi - mentor/

3. 
/ Prof. Ass. Lulzim Millaku - anëtar/

P.S. Numri i faqeve shtohet sipas nevojës.